



Project is financed by
European Union



KOMUNA E LIPJANIT
OPSHITINA LIPJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN



Empowered lives.
Resilient nations.

Në kuadër të Memorandumit të Mirëkuptimit të nënshkruar në mes të Komunës së Lipjanit dhe të Projektit të ReLOaD (Programit Rajonal për Demokracinë Lokale në Ballkanin Perëndimor), që financohet nga Bashkimi Evropian dhe zbatohet nga Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP) shpallin këtë:

THIRRJE PUBLIKE PËR NOMINIMIN E PËRFAQËSUESIT TË ORGANIZATAVE TË SHOQËRISË CIVILE NË KOMISIONIN VLERËSUES

Në bazë të *Rregullores MF – NR – 04/2017 Mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve (Neni 8)*, projekti ReLOaD dhe Komuna e Lipjanit shpallin Thirrjen Publike për nominimin e dy përfaqësuesëve nga grupi i ekspertëve të jashtëm, njeri nga të cilët duhet të jetë përfaqësues i OJQ-ve, si pjesë e Komisionit Vlerësues për projekt-propozimet e OJQ-ve në cilësinë:

- Një përfaqësues nga OJQ-të,
- Një përfaqësues nga shoqëria civile në cilësinë e ekspertit

Personi kandidat i nominuar për Komisionin Vlerësues duhet të dorëzoj **CV** (ku specifikohen përvojat e mëhershme në fushën e zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit të projekteve të ndryshme), dhe një **Letër Interesimi për Pjesëmarrje** (ku prezanton arsyet mbi interesimin për pjesëmarrje në këtë Komision).

Përfaqësuesit e shoqërisë civile duhet të jenë përgjithësisht veprimtarë të njohur dhe me reputacion në komunitetin lokal që kanë aftësinë të bëjnë vlerësim të paanshëm. Këta anëtarë të komisionit përzgjidhen nga OSHC-të në mënyrë transparente dhe gjithëpërfshirëse.

Afati i fundit për dorëzimin e nominimeve për përfaqësuesit e OShC-ve është **12.03.2018, në ora 15:00.**

CV dhe Letër Interesimi për Pjesëmarrje të dorëzohen në Komunën e Lipjanit, Rruga Shqipëria, Lipjan, 14000, përmes Arkivës, në Zyrën Nr. 110, Objekti i Komunës, kati i dytë, Bukurije Zejnullahu, Zyrtare e Lartë për Informim me Publikun dhe të shkruhet në subjekt pozitën për anëtar të komisionit për të cilin aplikoni.

Ju mirëpresim.